

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-171/14

**Prishtinë,
9 Mars 2016**

Në çështjen juridike të:

S.M.B.

Norvezanska 33/4

Leskovc, Serbi

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA16096 dhe KPA16097), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 9 Mars 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga S.M.B. , të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-171/2014 dhe GSK-KPA-A-172/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-171/2014.
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e paraqitura nga S.M.B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013, të datës 27 nëntor 2013, lidhur me kërkesat e regjistruara në AKP me numrat KPA16096 dhe KPA16097.
3. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013, i datës 27 nëntor 2013, lidhur me kërkesat me numrat KPA16096 dhe KPA16097.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 22 shtator 2006, S.M.B. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur dy kërkesa individuale në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), të regjistruara si lënda nr. KPA16096 dhe lënda nr. KPA16097, ku kërkon ri-posedimin e dy lokaleve afariste, që të dyja në ngastrën nr. 1024/1, me sipërfaqe prej 56 metrash katrorë (kërkesa e regjistruar me numrin KPA16096) dhe 38 metrash katrorë (kërkesa e regjistruar me numrin KPA16097), që ndodhet në Rrugën “Trg Republike” 43 në Pejë (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar).
2. Së bashku me kërkesat pala ankuese ka dorëzuar *inter alia* në AKP:
 - Vendimin mbi Ndarjen nr. 463-1244/98-I/8 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Pejës më 22 dhjetor 1998 për ndarjen në shfrytëzim të përhershëm pa kompensim për palën ankuese të tokës ndërtimore urbane, domethënë ngastrën kadastrale nr. 1024/1 në dy ngastra me sipërfaqe të përgjithshme prej 47 metrash katrorë në të cilat ai kishte ndërtuar dy lokale afariste: në anën perëndimore të ngastrës me sipërfaqe prej 28 metrash katrorë dhe në anën lindore të ngastrës me sipërfaqe prej 19 metrash katrorë. Sipas dispozitivit të vendimit toka është ndarë në shfrytëzim me qëllim që të legalizohen ngastrat për shfrytëzim të përhershëm të lokaleve të lartpërmendura afariste ku shfrytëzuesi kryen shërbimet e regjistruara pranë organit ekonomik kompetent në Pejë.

3. AKP ka siguruar *ex officio* Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 2608/2007 ku Komuna e Pejës ceket si pronare e ngastrës kadastrale nr. 1024/1 ku ishte ndërtuar prona e kërkuar.
4. AKP gjithashtu ka pranuar konfirmimin e Komunës së Pejës se vendimi i lartpërmendur i ndarjes nuk gjendet në arkivat e tyre dhe sipas “Departamentit për Çështje Pronësoro Juridike” nuk ka asnjë efekt juridik - verifikimi është negativ.
5. AKP ka kontaktuar palën ankuese dhe ka kërkuar dorëzimin e dokumenteve shtesë të cilat dëshmonin të drejtën mbi pronën e kërkuar. Pala ankuese e kishte informuar AKP-në se ai nuk kishte dokumente të tjera në posedim.
6. Identifikimi i pronave të këruara ishte bërë më 27 qershor 2007, 21 korrik 2008, 4 gusht 2008, 2 shtator 2010, 4 maj 2012 dhe 8 nëntor 2012. Prona e kërkuar ishte gjetur e lirë. Askush nuk mori pjesë si palë përgjegjëse në kërkesë në procedurë.
7. Më 27 nëntor 2013, KKPK në Vendimin e vet KPCC/D/C/224/2013 ka refuzuar kërkesat me arsyetimin se pala ankuese nuk e ka dëshmuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore ndaj pronës së kërkuar.
8. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 13 mars 2014. Më 10 prill 2014 ankesat janë paraqitur nga pala ankuese.

Pretendimet e palës ankuese

9. Në ankesat e tij, pala ankuese pretendon se Vendimi i KKPK-së përfshinë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Pala ankuese thekson se ai ka dorëzuar prova të mjaftueshme mbi bazën e të cilave të drejtat e pretenduara pronësore kanë mundur të vërtetoheshin. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme të njoh të drejtën e tij për ri-posedimin e pronës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesave

10. Ankesat janë paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh siç përcaktohet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Bashkimi i ankesave

11. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, thekson se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkriura kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të Ligjit. Ky nen e lejon Gjykatën Supreme të merr në konsideratë bashkimin apo shkrirjen e ankesave në mënyrë që të shqyrtoj dhe marrë vendime kur ka çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
12. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që janë të aplikueshme në procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozitat e nenit 408.1 lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashohin mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efektivitetin dhe efikasitetin e gjykatës lidhur me lëndën.
13. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën ankesa përkatëse është paraqitur, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë tërësisht të njëjta në të dyja rastet. Vetëm ngastrat, subjekt i të drejtës pronësore e cila pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjti.
14. Prandaj ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-171/14 dhe GSK-KPA-A-172/14 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-155/14.

Meritat e ankesës

15. Ndryshe nga pretendimet e palës ankuese Gjykata Supreme është e mendimit se pala ankuese nuk ka prezantuar prova të mjaftueshme që të vërtetohen të drejtat e kërkuara të pronës. Me Vendimin e prezantuar të Ndarjes nr. 463-1244/98-I/8 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Pejës më 22 dhjetor 1998, palës ankuese i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të përhershëm pa kompensim në ngastrën kadastrale nr. 1024/1 në dy ngastra me sipërfaqe të përgjithshme prej 47 metrash katrorë në të cilat ai ka ndërtuar dy lokale afariste: në anën perëndimore të ngastrës me sipërfaqe prej 28 metrash katrorë dhe në anën lindore të ngastrës me sipërfaqe prej 19 metrash katrorë. AKP ka siguruar ex officio Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 2608/2007 në të cilën përmendet Komuna e Pejës si pronare e ngastrës së lartpërmendur kadastrale dhe gjithashtu ka pranuar deklaratën e Komunës së Pejës se Vendimi i prezantuar i Ndarjes nr. 463-1244/98-I/8 nuk ekziston në arkivat e tyre dhe sipas “Departamentit për Çështje Pronësore Juridike” ai nuk ka ndonjë efekt juridik. Mund të konstatohet se verifikimi është negativ.
16. Pala ankuese nuk ka prezantuar prova të tjera për të mbështetur pretendimet e tij.

17. Prandaj, KKPK ka vepruar drejtë kur ka refuzuar kërkesat. Nuk ka pasur as shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se ankesat janë të pabazuara.
18. Nga ajo që u tha më lartë e në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it